



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 52/1 prot.

Tiranë, më 16.1.2024

**VENDIM**  
**Nr. 3, datë 16.1.2024**

**PËR**  
**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË**  
**VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 104, datë 07.12.2023**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të ndryshuar, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit për Zbatimin e Vendimeve Paralajmëruese dhe Koordinimit, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit nr. 104, datë 07.12.2023, *“Mbi përfundimin e procesit të inspektimit për vlerësimin e ligjshmërisë, të veprimeve administrative të kryera gjatë procedurës së konkurrimit për plotësimin e pozicionit të punës “Përgjegjës i Sektorit të Integritit Europian dhe Ndihmës së Huaj”, në Bashkinë Divjakë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar paligjshmërinë e konstatuar”*.

**KONSTATOVA SE:**

Pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil me shkresën nr. 1007 prot., datë 19.10.2023, është paraqitur një informacion nga punonjësja e Bashkisë Divjakë, \*\*\*\*\* , pjesëmarrëse në procedurën e konkurrimit për plotësimin e pozicionit *“Përgjegjës i Sektorit të Integritit Europian dhe Ndihmës së Huaj”*, pranë Bashkisë Divjakë, për të cilën pretendohet se ka pasur parregullsi gjatë aplikimit të ligjit për nëpunësin civil.

Për verifikimin e informacionit, bazuar në nenin 16, kreu III, *“Procedura paraprake”*, të Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr.17, datë 11.3.2015, të ndryshuar, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, është kryer hetimi administrativ i këtij rasti.

Në përfundim të këtij hetimi administrativ procesi është përmbyllur me vendimin nr. 104, datë 07.12.2023, të Komisionerit, *“Mbi përfundimin e procesit të inspektimit për vlerësimin e ligjshmërisë, të veprimeve administrative të kryera gjatë procedurës së konkurrimit për plotësimin e pozicionit të punës “Përgjegjës i Sektorit të Integritit European dhe Ndihmës së Huaj”, në Bashkinë Divjakë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar paligjshmërinë e konstatuar”*.

Brenda afatit të lënë në Vendimin e mësipërm, Bashkia Divjakë, me shkresën nr. 7063/1 prot., datë 21.12.2023, administruar nga Komisioneri me nr. 1007/6 prot., datë 21.12.2023, ka njoftuar mbi veprimet administrative të ndërmarrë në zbatim të detyrave të lëna në dispozitivin e vendimit paralajmërues, duke bashkëlidhur dokumentacionin provues.

Mbështetur në detyrat e lëna në Vendimin nr. 104, datë 07.12.2023, si dhe duke verifikuar veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse, materializuar në dokumentet shkresore përkatëse, situata e administrimit të shërbimit civil në institucionin objekt i këtij verifikimi, paraqitet si më poshtë vijon:

Për rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë, në pikën 1 të vendimit paralajmërues, Komisioneri ka kërkuar nga njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Divjakë, të nxjerrë aktin e emërimit për kandidaten \*\*\*\*\* në pozicionin *“Përgjegjës i Sektorit të Integritit European dhe Ndihmës së Huaj”*, në Bashkinë Divjakë.

Rezulton se, me akt-emërimin nr. 3112/14 prot., datë 15.12.2023, është vendosur emërimi si nëpunës civil, në pozicionin *“Përgjegjës i Sektorit të Integritit European dhe Ndihmës së Huaj”*, Bashkia Divjakë të \*\*\*\*\* në përputhje me detyrat e lëna nga Komisioneri.

Për sa u parashtrua më sipër, vlerësoj se, nga ana e institucionit objekt i mbikëqyrjes në vazhdim, Bashkia Divjakë, janë zbatuar detyrat e lëna në vendimin paralajmërues të Komisionerit.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”* dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të ndryshuar, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

### **VENDOSA:**

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit nr. 104, datë 07.12.2023, të Komisionerit, *“Mbi përfundimin e procesit të inspektimit për vlerësimin e ligjshmërisë, të veprimeve administrative të kryera gjatë procedurës së konkurrimit*

*për plotësimin e pozicionit të punës “Përgjegjës i Sektorit të Integritit European dhe Ndihmës së Huaj”, në Bashkinë Divjakë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar paligjshmërinë e konstatuar”.*

2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit, Bashkia Divjakë, duke zbatuar detyrat e lëna në dispozitivin e Vendimit nr. 104, datë 07.12.2023.
3. Për këtë vendim të njoftohet Bashkia Divjakë dhe nëpunësi \*\*\*\*\*.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**